



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1787/2 prot.

Tiranë, më 27.07.2026

V E N D I M

Nr. 27, datë 27.07.2026

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikave 3 dhe 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. (në vijim “ankuesja”) ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) formularin e ankesës me nr. 1787 prot., datë 26.06.2026, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Fier” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, me anë të kërkesës së datës 10.05.2026, depozituar në adresën elektronike info@bashkiafier.gov.al, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni, për periudhën 2020 – 2025, në lidhje me:

1. *Buxheti vjetor i miratuar për kulturën dhe realizimi faktik i tij, të ndara sipas programeve buxhetore dhe institucioneve përfituese;*
2. *Numri i aktiviteteve, festivaleve ose projekteve kulturore të organizuara ose të mbështetura financiarisht nga bashkia për çdo vit gjatë periudhës 2020 – 2025;*
3. *Të dhëna mbi fondet publike të shpërndara në fushën e kulturës, duke specifikuar për çdo vit:*
 - *numrin total të përfituesve;*
 - *vlerën totale të fondeve të shpërndara;*
 - *ndarjen sipas kategorive të aktiviteteve të mbështetura.*
4. *Lista e institucioneve kulturore në varësi të bashkisë, duke specifikuar:*
 - *funksionin;*
 - *vendndodhjen;*
 - *numrin e punonjësve.*

5. Numri i punonjësve të angazhuar në strukturat përgjegjëse për kulturën në bashki për çdo vit gjatë periudhës 2020 – 2025;
6. Informacion mbi fondet e përdorura për restaurime, rehabilitime ose ndërhyrje në objekte të trashëgimisë kulturore, duke specifikuar:
 - objektin;
 - llojin e ndërhyrjes;
 - vitin e realizimit;
 - vlerën e financimit.
7. Lista e strategjive, planeve lokale ose dokumenteve politike në fushën e kulturës të hartuara ose zbatuara gjatë periudhës 2020 – 2025;
8. Numri i konsultimeve publike të zhvilluara në lidhje me kulturën, trashëgiminë kulturore ose aktivitetet kulturore gjatë periudhës 2020 – 2025;
9. Të dhëna mbi hapësirat publike ose infrastrukturën e përdorur për aktivitete kulturore gjatë periudhës 2020 – 2025;
10. Nëse ekzistojnë, të dhëna mbi të ardhurat e gjeneruara nga institucionet kulturore në varësi të bashkisë gjatë periudhës 2020 – 2025;
11. Në rast se bashkia disponon strategji, plane veprimi ose projekte në proces për zhvillimin e kulturës, industrive kreative ose trashëgimisë kulturore për periudhën në vijim, ju lutem vini në dispozicion informacion mbi statusin aktual të tyre;
12. Ju lutem specifikoni të dhëna mbi shpërndarjen e aktiviteteve, investimeve ose infrastrukturës kulturore sipas njësive administrative të bashkisë gjatë periudhës 2020 – 2025.

Në mungesë të një përgjigjeje nga Autoriteti Publik, ankuesja, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka paraqitur ankim pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informacion datë 10.05.2026.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri, nëpërmjet shkresës nr. 1787/1 prot., datë 30.06.2026, ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar, brenda datës 07.07.2026.

Me kalimin e afatit të përcaktuar më sipër, Autoriteti Publik nuk ndërmori asnjë masë për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Në këto rrethana, pas shqyrtimit të objektit të ankimit, si dhe konsultimit të legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerëson se informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2 të nenit 2 të LDI-së, sipas të cilit: *“Informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdolloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”*.

Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm, pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duhet të mbajë në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të LDI-së, ku përcaktohet se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI-së, parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”*.

Në kuptim të këtij parashikimi, Bashkia Fier është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI-së, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundur realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1, përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike”*. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik, pavarësisht nëse është në cilësinë e “prodhuesit” apo “mbajtësit” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.

Si përfundim, Komisioneri thekson se LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Detyrimi për bërjen transparente të veprimtarisë së tyre, njësive të qeverisjes vendore iu lind gjithashtu edhe në zbatim të Kreut VI të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Konkretisht, në nenin 15 të ligjit të sipërcituar “Transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore”, parashikohet se: *“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre. 2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike...”*.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të LDI-së: “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik nëpërmjet dokumentit origjinal, ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

Ky qëndrim i Komisionerit gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen *Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë* (aplikimi nr. 37374/05, datë 14.04.2009) vlerësoi se pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë, të realizojnë punën e “mbikëqyrësit shoqëror”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dyja palëve.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në shkronjat “b” dhe “ç” të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së znj. _____, me nr. 1787 prot., datë 26.06.2026, ndaj Autoritetit Publik “Bashkia Fier”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 10.05.2026, konkretisht: “Për periudhën 2020 – 2025: 1. Buxheti vjetor i miratuar për kulturën dhe realizimi faktik i tij, të ndara sipas programeve buxhetore dhe institucioneve përfituese; 2. Numri i aktiviteteve, festivaleve ose projekteve kulturore të organizuara ose të mbështetura financiarisht nga bashkia për çdo vit gjatë periudhës 2020 – 2025; 3. Të dhëna mbi fondet publike të shpërndara në fushën e kulturës, duke specifikuar për çdo vit: numrin total të përfituesve; vlerën totale të fondeve të shpërndara; ndarjen sipas kategorive të aktiviteteve të mbështetura; 4. Lista e institucioneve kulturore në varësi të bashkisë, duke specifikuar: funksionin; vendndodhjen; numrin e punonjësve; 5. Numri i punonjësve të angazhuar në strukturat përgjegjëse për kulturën në bashki për çdo vit gjatë periudhës 2020 – 2025; 6. Informacion mbi fondet e përdorura për restaurime, rehabilitime ose ndërhyrje në objekte të trashëgimisë kulturore, duke specifikuar: objektin; llojin e ndërhyrjes; vitin e realizimit; vlerën e financimit; 7. Lista e strategjive, planeve lokale ose dokumenteve politike në fushën e kulturës të hartuara ose zbatuara gjatë periudhës 2020 – 2025; 8. Numri i konsultimeve publike të zhvilluara në lidhje me kulturën, trashëgiminë kulturore ose aktivitetet kulturore gjatë periudhës 2020 – 2025; 9. Të dhëna mbi hapësirat publike ose infrastrukturën e përdorur për aktivitete kulturore gjatë periudhës 2020 – 2025; 10. Nëse ekzistojnë, të dhëna mbi të ardhurat e gjeneruara nga institucionet kulturore në varësi të bashkisë gjatë periudhës 2020 – 2025; 11. Në rast se bashkia disponon strategji,

plane veprimi ose projekte në proces për zhvillimin e kulturës, industrive kreative ose trashëgimisë kulturore për periudhën në vijim, ju lutem vini në dispozicion informacion mbi statusin aktual të tyre; 12. Ju lutem specifikoni të dhëna mbi shpërndarjen e aktiviteteve, investimeve ose infrastrukturës kulturore sipas njësive administrative të bashkisë gjatë periudhës 2020 – 2025”, brenda datës 04.08.2026, në përputhje me parashikimet e pikës 6 të nenit 17 dhe pikës 6/1 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.

Ky vendim u shpall sot, më datë 27.07.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi